



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 5991₁₃ Prot.

Tiranë, më 17.05.2023

Lënda: Kërkesë për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike të datës 22.05.2023

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Tiranë

Në zbatim të Kreut II pika 13 e VKM nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore” i ndryshuar, dhe Lidhjes 1, Shtojca 1 e Udhëzimit të Ministrit të Kulturës nr. 269 datë 11.08.2020 i ndryshuar, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim “FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK”.

Njoftimi ju dërgohet edhe në format elektronik (CD) si dhe në adresën zyrtare të emailit – info.app@app.gov.al.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Klesta Qirici



FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Tiranë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **Kisha e Ungjillizimit Kozarë, Kuçovë, Berat, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.**
3. Llojin e punës: **“Restaurimi i “Kisha e Ungjillizimit Kozarë” Kuçovë-Berat**
4. Fondi limit i procedurës së konkurrit: **12.500.000** (*dymbëdhjetë milion e pesëqind mijë*) lekë **pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **180 ditë**, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është jo më pak se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinën e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **12.06.2023 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentat standarte të konkurrit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: www.iktk.gov.al në Rubrikën “Rreth nesh/Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë **12.06.2023 ora 11:00** në Autoritetin Kontraktor/Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Tiranë, kati II, salla e Bibliotekës, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 15 ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.